



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

## **SHPLLJE KËRKESË PËR DONACION**

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT), është Institucion Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullit, të cilit i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas ligjeve në fuqi, i cili ka në fokus të aktivitetit të tij mbrojtjen e jetës, shëndetit fizik dhe mendor të pacientit dhe lehtësimin e vuajtjeve të tij, duke i ofruar një shërbim shëndetësor sa më cilësor dhe dinjitoz.

Me anë të kësaj thirrje, QSUNT dëshiron të kërkojë vëmendjen e publikut lidhur me mundësinë për të kontribuar në përmirësimin e shërbimit dhe ofrimin e ndihmës në rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve të hospitalizuar në QSUNT.

Pranë Shërbimit të Kardiokirurgjisë gjejnë trajtim një pjesë e mirë e popullatës për sëmundjet e arterieve koronare, sëmundjeve të lindura apo të fituara të valvulave të zemrës, sëmundjeve të enëve të mëdha, etj. Për optimizimin e shërbimit, si dhe për rastet e rënda ku lind nevoja absolute për oksigjenimit ekstrakorporal me membranë është e nevojshme furnizimi nëpërmjet një donacioni të këtyre dy pajisjeve, konkretisht: pajisje Oksigjenimi ekstrakorporal me membranë (ECMO) dhe pajisje ri-hidratimi të balancuar pas diurezës së forcuar nëpërmjet RenalGuard® (ose ekuivalent).

**QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”**